



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 7137 Prot.

Tiranë, më 26.09 2018

DEKLARATË MJEDISORE
për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të nenit nr. 12 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË PËRMET

Kufijtë e zonës që mbulon plani: sipërfaqja në administrimin e bashkisë Përmet, njësitë e saj administrative.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimin:

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, plani në tërësi, si dhe të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përputhja e planit të propozuar me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin mjedisor:

Plani i propozuar përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe plotëson kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Objektivat Mjedisorë të PPV-së për Bashkinë Përmet paraqiten:

- me përputhshmëri të lartë mjedisore në masën 2.5 – 3 pikë,
- me përputhshmëri të pjesshme në masën 1.5 – 2.49 pikë,
- me përputhshmëri të zbehtë në masën 0.01 – 1.49 pikë,
- me përputhshmëri neutrale në masën 0 pikë,
- me ndikim të theksuar në mjedis: Negativ.

Ndikimet që rrjedhin nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor janë vlerësuar kryesisht të kenë karakter me intensitet të ulët dhe në disa raste rehabilitues e të domosdoshëm për të sistemuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit në Bashkinë Përmet. Theksojmë se të gjitha politikat e planit janë në përputhje me objektivat mjedisor.

Arsyetimi se si janë marrë në konsideratë mendimet e publikut për pasojat në mjedis të planit:
Në dokumentacionin e dorëzuar si dhe referuar kërkesës së bashkisë Përmet gjatë konsultimit me publikun në territorin e kësaj bashkie, disa ide të dhëna nga ekspertët lokalë nuk janë konsideruar në plan dhe për

pasojë nuk janë konsideruar në VSM, me arsyetimin se binin ndesh me parime të rendësishme mjedisore si ai për mbrojtjen e biodiversitetit apo zonat e mbrojtura mjedisore.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten ndikime pozitive dhe negative. Ndikimet pozitive priten në përmirësimin e jetesës për popullatën si dhe në asetet materiale. Pjesa pozitive e impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi, që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë ndikime negative mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative do jenë të lidhur **me fazën e zbatimit** (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi zona ka veçori të theksuara dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Ndikime negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe ndikimet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqëndrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë por kjo do të ndikojë vetëm gjatë **fazës së zbatimit** të projekteve specifike.

Masat zbutëse që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efciente në përdorimin e energjisë, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri, po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Plani duhet të nxisë realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujrave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitete e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të

komunikohet/bashkëpunohet me AKZM-në për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave.

- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të perfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do zbatohen mund të prekin zona të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Plani të marrë masa për promovimin e transportit publik të pasagjerëve që të kontribuojnë në pakësimin e shkarkimeve në ajër.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve nën mbrojtje. Promovimi brenda dhe në periferitë e zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelbërta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të kenë objektiva të matshme për cilësinë e ajrit.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadër të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përmytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësisë autoktone që i rezistojnë edhe përmytjeve).
- Të zbatohen kërkesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërta, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.
- Para fillimit të zbatimit të projekteve, të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices“.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.
- Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- Nëse plani nuk është miratuar brënda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëhere deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëhere ministria njofton menjëherë autoriteteve përgjegjës për zbatimin e miratimin e planit dhe sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.
- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëhere ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masat e duhura për

shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.

- Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore.

Kërkesat për monitorimin mjedisor periodik gjatë zbatimit të planit:

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brënda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.

Kërkesa për raportim mjedisor periodik

- Bashkia Përmet, nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit duhet të hartojë periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

MINISTËR


Blendi KLOSI